

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS Aktiviteti “Pike furnizimi karburanti dhe GLN”



Vendodhja: Fshati Dhuvjan, rruga nacionale Gjirokaster-Kakavie , Dropull i Poshtem, Gjirokaster

Subjekti : A-TU shpk

Tirane 2022

HYRJE

Raporti synon te jape nje informacion te detajuar dhe te besueshem lidhur me ndikimin mjedisor te projektit te propozuar ne perdorimin e tokes, efektet lidhur me ndikimet ne floren, faunen, burimet e ujit, shkarkimet ne toke, uje, si dhe çdo ndikim social ekonomik ne punesimin lokal, permiresimin e infrastruktures dhe ndikimeve te tjera te rendesishme mjedisore ose sociale, perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permisimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet :

- Marrjes ne konsiderate te çeshtjeve te mjedisit ne fazen e pergatitjes se projektit.
- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit te aktivitetit mbi mjedisin human.
- Analizen e faktoreve pozitive e negative mjedisore, percaktimin e masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative.
- Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimin cilesor te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne projekt.

Per kete problem u be mbikqyrja e terrenit ne te gjithë zonen, duke kryer vrojtime te ndryshme , si dhe te biodiversitetit.

Ne raport jepet statusi i territorit, korniza ligjore e tij, mjedisi biofizik, gjeologjia e rajonit, gjeologjia e zones, hidrogeologjia.

Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk eshte i rendesishem vetem per njerezit por eshte thelbesor dhe i nevojshem per te gjitha qeniet ne toke. Njerezit duhet te kuptojne se si perdorimi i burimeve mjedisore dhe perfitimet qe vijne nga ato te mos demtohen por te jete e mundur te perfitohet sot dhe ne te ardhmen.

Termi mjedis dhe burime natyrore perdoren shpesh por jo gjithmone me kuptimin e qarte qe i perkufizon . Burimet natyrore i referohen burimeve te tokes, ujerave sipërfaqesore dhe nentokesore , ajrit qe rrethon token, çdo gje qe rritet ne toke apo det si dhe burimet qe gjenden nentoke si psh mineralet. Mjedisi eshte me gjithperfshires, cdo gje qe na rrethon.

Thjesht duke perdorur burimet natyrore ne rrezikojme ne mbiperdorimin dhe shterimin e tyre . Shterimi i burimeve natyrore eshte nje nga problemet thelbesor te çrregullimit te mjedisit. Ne te perfshihet shterimi i ujit, mineraleve perfshire dhe lendet fosile si dhe shume burime te tjera.

Çdo veprimtari e kryer nga njeriu shoqerohet edhe me impakt ne mjedis. Pra impakti mjedisor i referohet ndryshimit te mjedisit natyror nga aktiviteti njerezor.

Kemi dy tipe te impaktit mjedisor

- Shterimi i burimeve
- Ndotja

Ne menyre qe te shmangen keto probleme njerezimi duhet te mesoj se si te menaxhohen burimet natyrore ne menyre te qendrueshme. Pra zhvillimi i qendrueshem i burimeve natyrore nuk eshte gje tjeter vecse perdorimi i tyre ne menyre ekonomike nga brezat e sotem per ti len keto burime te perdoren edhe nga brezat qe do te vijne.

Qendrueshmeria perfshin menaxhimin e gjithë perberesve dhe burimeve natyrore e njerezore me qellim qe te pasurohen me kalimin e kohes dhe te sigurohet nje mireqenie per te gjithë. Zhvillimi i qendrueshem nuk i pranon politikat te cilat cojne ne uljen e bazes prodhuese dhe lene gjeneratat e ardhshme me prespektiva me te ulta (te varfëra) dhe/ose rreziqe me te medha se te tonat. Teknologjite qe kontribuojne ne zhvillimin e qendrueshem perfshijne kontrollin e ndotjes,

prodhimin e energjise se riciklueshme, rikuperim burimesh dhe riciklim, menaxhim burimesh dhe kerkime shkencore.

Problemet mjedisore ne vendin tone lidhen me ndotjen e ajrit ne qytetet kryesore , ndotja e ujit e cila vjen nga shkarkimi i ujerave te ndotura pa u trajtuar fillimisht dhe mbetjet urbane te cilat jo te gjitha depozitohen ne vendet e caktuara.

INFORMACION PER QELLIMIN E VNM DHE METODIKEN E ZBATUAR

Pershkrim te qellimit dhe objektivave te VNM

Vleresimi i ndikimit ne mjedis eshte nje proces ne vazhdimesi i aktivitetit dhe siguron se ndikimet mjedisore te rendesishme, sinjifikante jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim, zbatim te aktivitetit qe do te zhvillohet.

Qellimi i VNM- se

Qellimi i hartimit te raportit te VNM-se eshte percaktimi i efekteve negative dhe pozitive te aktivitetit dhe masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis si rezultat i zhvillimit te **pikes se furnizimit me karburant.**

VNM nuk do te mbuloj çdo aspekt te nje efekti mjedisor te projektit, me te njejtin nivel detajesh. Theksi do te vihet ne ndikimet kryesore qe shkakton zhvillimi i aktivitetit.

Gjithashtu nje synim tjetër eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike- organizative per zbutjen e aneve negative qe mund te krijohen gjate zhvillimit te aktivitetit dhe te jape informacion per vendim-marresit per pasojat mjedisore te aktiviteteve te propozuara.

VNM perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet :

- Marrjes ne konsiderate te ndikimeve te mjedisit qe ne fazen e pergatitjes se propozimeve ne projekt.
- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit ne mjedise te aktivitetit mbi mjedisin human.
- Analizes se faktoreve pozitive e negative mjedisore dhe te masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative.
- Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimi cilesor me pika te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne mjedis te projektit.

Objektivat e VNM

Objektivat e hartimit te VNM- se konsistojne ne evidentimin dhe reduktimin e ndikimeve ne mjedis dhe masat tekniko-organizative per nje zhvillim te qendrueshem te mjedisit, gjate kryerjes se aktivitetit deri ne perfundim te tij dhe rehabilitimin e hapesires perreth objektit.

Me kete studim informojme organet vendim-marres, mbi ndikimet ne mjedis dhe perfitimet e projektit te propozuar. Gjithashtu zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe zbatimi i projektit nuk prek burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose veprimtari.

Objektivat e tjera te studimit te paraqitur jane.

- Permiresimet mjedisore te zones ku zbatohet projekti dhe rreth saj.
- Perdorimin e burimeve natyrore ne menyren te qendrueshme ku respektohen dhe kerkesat e komunitetit te zones per rreth.
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale negative te projektit te zbatuar
- Lehteson informimin e organeve vendim-marrese, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.
- Mbrojtjen e shendetit te njeriut.
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit.
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peziashet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve.
- Permireson aspektet sociale te projektit.

Pershkrim i metodikes te zbatuar per hartimin e raportit te VNM

Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis hartohet me kerkesa te shoqerise **per zhvillimin e aktivitetit pike furnizimi me karburant.**

Studimi i vleresimit te ndikimit ne mjedis u orientua nga rendesia dhe madhesia e projektit, vendi ku ai do te zhvillohet , pasurite natyrore dhe humane te zones si dhe vlerat e vecanta te tyre ne identifikimin e ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutese duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike te investitorit dhe masat orientuese pas mbylljes se projektit. Reduktimi i ndikimeve negative eshte nderthurur edhe me ndikime te rendesishme pozitive sidomos ne perfitime direkte dhe indirekte mbi komunitetin.

Studimi strukturohet ne kater faza kryesore :

- 1.Ngritja e objektivave orientuese te V.N.M.
- 2.Mbledhja e materialit baze ekzistues dhe atij te formuluar enkas per kete projekt dhe seleksionimi i tyre per perdorim.
- 3.Verifikimi ne terren i te dhenave ekzistuese dhe mbledhja e te dhenave te mundeshme biofizike dhe humane.
- 4.Hartimi i projektit bazuar ne legjislacionin Shqiptar si dhe kerkesave te organeve vendim-marrese dhe kontrollues te objekteve mjedisore ne nivel kombetar dhe lokal.

PERSHKRIM I PROJEKTIT TE PROPOZUAR

Qellimi i projektit te propozuar

Qellimi i zhvillimit te aktivitetit eshte furnizimi me karburant i mjeteve.

Vendodhja e zhvillimit te projektit

Aktiviteti i furnizimit me karburant i makinave ne një stacion të furnizimit me karburant, do te zhvillohet ne pasurin me nr. 211/297, zk 1487, Gjirokaster.

Kapaciteti depozitues
15 000 litra nafte
10 000 litra benzine
5000 litra GLN

Mbushja e depozitave behet pa nderprerje te procesit te shitjes. Remontet eventuale dhe te vazhdueshme te pikes se shitjes dhe ato ne raste avarish, mund te behen ne vazhdim dhe pa nderprerjen e tregimit te karburantit.

Rezervuaret jane te futur ne toke dhe te mbeshtetur ne jasteke betonit, ku anash jane te mbushur me stabilizant per te krijuar sigurine maksimale te tyre.

Operimi ne piken e karburantit eshte 7 dite ne jave nga 24 ore.

Skema teknologjike e furnizimit te rezervuareve me karburante eshte zgjedhur e tille qe siguron furnizimin e tyre me cikël te mbyllur per te evidentuar aromat dhe avullimin e tyre ne mjedis, gjithashtu edhe per te evidentuar rrezikun e zjarrit gjate furnizimit te rezervuareve ne temperatura te larta.

Per furnizimin e automjeteve me karburante sherbejne aparaturat (distributore) elektronike qe kane nje precizion kalibrimi ne te mjtat e litrit. Keta distributore furnizohen nga pompat perkatesisht te vendosur ne rezervuaret perkates.

Per manovrimin e mjeteve brenda pikes se karburantit jane zbatuar kushtet teknike, ku eshte projektuar korsia e ngadalesimit te mjetit, furnizimi me karburant ne te dy anet e distributoreve (pasi ka mjete qe kane furnizimin ne karburant ne ane te djathte ose majte), distanca minimale e zyres nga distributor por edhe e distributoreve ndermjet tyre eshte e mjaftueshme qe mjetet te keni mundesi te kalojne lehte. Ne dalje te karburanti eshte edhe korsia e pershpejtimit ku mjeti futet ne korsine e rruges kryesore. Ne hyrje te karburantit dhe dalje te tij jane vendosur tabelat sinjalizuese.

Kordinatat e vendodhjes jane :

NR.	Y	X
1.	4433008.98	4429967.85
2.	4433002.37	4429977.16
3.	4432996.16	4429973.17
4.	4432993.82	4429976.56
5.	4433002.43	4429982.76
6.	4433004.08	4429980.64
7.	4433013.82	4429987.68
8.	4433021.68	4429976.67

PLANIMETRIA E PIKES SE KARBURANTIT e GLN



- LEGJENDA :
- 1 BANESE ATUNI
 - 2 DISTRIBUTOR SHITJE
 - 3 DEPOZITA NAFTE V=15000 Litra
 - 4 DEPOZITA BENZINE V=10000 Litra
 - 5 DEPOZITA GLN V= 5000 Litra



Flora 2 Lit

"EXPERT PRIVAT ZJARRIFIKES"
Ing. GAQE MEÇI
 Adresat: L.18 Shtatori, Gjirokastrë



- **Pershkrim i mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar dhe me fotografi**

Per nga origjina , perberja dhe vecorite gjeobotanike bimesia e Shqiperise ben pjese ne nenzonen floristike mesdhetare e cila perfshihet ne nje njesi me te madhe, ne zonen holarktike. Ndikim te madh ne zhvillimin e flores mesdhetare ushtroi ftohja e pergjithshme e klimes ne periudhen e pleistocenit dhe akullzimi i fuqishem qe pasoi ate. Tiparet karakteristike te bimesise mesdhetare si per sa i perket vecorive gjeobotanike ashtu edhe perberjes morfologjike dhe shtrirjes vertikale te saj, jane karakteristike edhe per bimesine e vendit tone. Por kushtet konkrete te zhvillimit, sidomos te klimes dhe te relievit kane percakt

E gjithë kjo pasuri floristike i detyrohet vecorive te evolucionit paleogjeografik te Shqiperise dhe sidomos larmise se madhe te klimes, copetimit te theksuar te relievit dhe formave te shumellojshme te tij, formacioneve te shumta shkembore (gelqerore, magmatike, terrigjene) etj. Fitocenozat e bimesise barishtore shume te larmishme nga perberja e llojeve, gjenden ne te gjitha zonat fitoklimatike te Shqiperise. Megjithese fitocenozat barishtore nga ana e fizionomise ne pergjithesi duken relativisht te peraferta, ato ndryshojne midis tyre nga perberja floristike ne varesi te faktoreve ekologjike. Me perjashtime te pakta, gati ne te gjitha fitocenozat dhe bashkeshoqerimet barishtore gjenden perfaqesues te familjes graminore (Graminaceae). Bimet qe rriten ne zonen ku do te shfrytezohet nuk gezojne status te vecante te ruajtjes kombetare dhe nderkombetare te tyre.

Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme negative ne mjedis te projektit perfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer

Ndotje te mjedisit mund te vijne

- Shperndarja e ererave te pakendeshme ne hapsiren qe kufizon territorin por dhe perreth tij, gjate manipulimeve te ndryshme qe kryhen ne piken e karburantit
- Rrjedhja e karburanteve apo lubrifikanteve gjate furnizimit te depozitave

Shkarkime ne uje

Nuk ka ndotje te ujerave nentokesore. Ujerat qe dalin nga aktiviteti jane ujera te cilat lindin si rrjedhoje e aktivitetit te larjes se ambienteve dhe ambientet higjenosanitare.gjithashtu vleresohen dhe ujerat e reshjeve atmosferike te cilat orientohen ne sistemin e e kanalizimeve kulluese te zones. Gjithesesi nuk duhet te shkarkohen lende te demshme ne mjedisin e punes. Duhet te punohet sipas rregullores se kushteve teknike ,nuk duhet te lejohen derdhje te karburanteve dhe lendeve te tjera djegese ne mjedisin e aktivitetit ,pasi ndotin ambjentin dhe mund te jene burim aksidenti e shkaktar te zjarreve te padeshiruara e me tej mund te shkaktojne edhe shperthime. Ne sheshin e aktivitetit nuk magazinohen materiale te rrezikshme dhe si rrjedhoje nuk ka ndotje te ujerave nentokesore ose siperfaqesore. Mundesite e ndotjes mund te vijne vetem nga derdhja e hidrokarbureve ose e lubrifikanteve gjate furnizimit te mjeteve te transportit.

Emetime ne ajer

Emetimet ne ajer identifikohen vetem nga procesi i avullimit te lendeve djegese fosile , por edhe si rrjedhoje e ndonje avarie ne sistem nga valvolat e sigurise. Keto lende jane te avullueshme ne temperatura te uleta dhe si rrjedhoje ne kushte normale atmosferike, sidomos gjate veres avujt e

karburanteve perhapen ne mjedis. Keto avuj jane me te rende se ajri ne siperfaqen e tokes dhe si rrjedhoje kane prirjen qe te depozitohen ne siperfaqet me te uleta te tokes, si gropa, siperfaqe ujore etj. Me kushtet atmosferike keto avuj shperndahen dhe nuk perbejne asnje problem per mjedisin e zones. Nuk vleresohen me ndikime domethenese. Sasi te tilla i asimilon vete atmosfera nepermjet proceseve natyrore te klimes. Tek punonjesit qe mund te jene te ekspozuar ne keto shkarkime rekomandohet perdorimi i maskave kundra gazeve te demshem.

Nje ndikim i rendesishem ne mjedisin atmosferik do te vleresohen rastet e renies se zjarrit ne objekt dhe djegia e karburantit. Kjo mundesi eshte e rralle por jo e perjashtuar. Nje ngjarje e tille do te shkaktoje ndotje serioze ne ajer, emetimin e sasive te medha te gazeve te demshem ne nje zone te caktuar dhe nje shtrirje siperfaqesore relativisht te madhe. Gjithashtu mjetet rrugore qe qarkullojne duhet te jene konform normave te percaktuara dhe te testuara nga Qendra e Kontrollit Teknik te automjeteve e te pajisura me certifikaten e Vertetimit Teknik nga IQT.

Depozitat e naftës nuk do të jenë burim emetimi tegazeve ndotese , për arsye se nuk ka proces djegie që mund të emetohen gaze në atmosferë. Gjithashtu, parashikohet që nuk do të shkaktohet pluhur gjatë funksionimit sepse të gjitha hapsirat dhe sheshet ku do të kalojnë dhe do të parkohen autobotet qe do te frunizojn depozitat do të jenë të shtruara me beton dhe në disa pjesë me asfalt.

Ndikimi ne toke

Keto procese pune ne kete aktivitet nuk ndikojne aspak ne toke. Shkarkimi i lendes djegese fosile ne mjedisin e zones mund te perbeje problem per ndotjen e tokes vetem ne rast te demtimit te depozites dhe rrjedhjes se karburantit, por nje gje e tille eshte pothuajse zero. Subjekti ka hartuar dhe zbaton planin e perballimit te emergjencave dhe si rrjedhoje e gjithe siperfaqja eshte e shtruar me beton.

Ndikimi ne biodiversitet

Sipas verifikimeve te kryera lloji i aktivitetit nuk ndikon ne biodiversitet. Projekti është ekzistues dhe nuk do të ndikoj në botën e gjallë, në florën dhe në faunën e zonës. Për vënien në funksionim të pikes se karburantit nuk është e nevojshme të realizohen punime ndërtimore, të cilat mund të shkaktonin ndikime negative në mjedis. Depozitat dhe infrastruktura ndihmëse janë në gjendje pune për të funksionuar aktiviteti.

Zhurmat dhe vibrimet

Zhurmat qe prodhohen vijne kryesisht nga mjetet rrugore si dhe nga perdorimi i elektropompave gjeneratoreve ndersa zhurma e prodhuar nga vet personat qe punojne per kete aktivitet nuk jane te vleresueshme. Punetoret qe ndodhen ne mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund te perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit. Kjo duhet te mbahet parasysh nga drejtuesi teknik. Nga zhvillimi i aktivitetit nuk gjenerohen vibrime.

Ndikime në peisazh

Depozitat e lendeve djegese fosile janë të instaluar prej shumë vitesh dhe aktiviteti është në gjendje funksioni. Për këtë arsye, vlerësohet që nuk shkaktohen ndikime në peisazh. Aktiviteti nuk fragmenton një peisazh natyror, që në rastin nëse do të ishte i tillë, ky aktivitet

do të ndikonte në peisazhin natyror. Kompania do të mirëmbajë mjediset e brendshme, do të zbatohen të gjitha standartet e aktivitetit të kësaj natyre, për të siguruar një mjedis të pastër dhe të sigurt.

Ndikime socio-ekonomike

Nuk parashikohen të shkaktohen ndikime negative nga zhvillimi i projekteve të tilla në pjesën sociale ekonomike, për arsye se këto projekte ndihmojnë në rritjen e kapaciteteve të furnizimit melende djegese te automjeteve.

Nje pershkrim per shkarkimet e mundshme ne mjedis te tilla si ujera te ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime si dhe per prodhimin e mbetjeve

Uji do perdoret per lagien e territorit per paksimin e pluhurave gjate procesit te levizjes se automjeteve per furnizimin me nafte dhe do sigurohet permes depozitave nga shoqeria.

Ujerrat e shiut do te sistemohen permes kanaleve perimetrike dhe me pas do i bashkohen kanalizimeve kulluese te zones. Theksojme se keto ujerrat nuk permbajn elemente kimike ndotes.

Emetimet ne ajer identifikohen vetem nga procesi i avullimit te lendeve djegese fosile , por edhe si rrjedhoje e ndonje avarie ne sistem nga valvolat e sigurise. Keto lende jane te avullueshme ne temperatura te uleta dhe si rrjedhoje ne kushte normale atmosferike, sidomos gjate veres avujt e karburanteve perhapen ne mjedis. Keto avuj jane me te rende se ajri ne siperfaqen e tokes dhe si rrjedhoje kane prirjen qe te depozitohen ne siperfaqet me te uleta te tokes, si gropa,siperfaqe ujore etj. Me kushtet atmosferike keto avuj shperndahen dhe nuk perbejne asnje problem per mjedisin e zones. Nuk vleresohen me ndikime domethenese. Sasi te tilla i asimilon vete atmosfera nepermjet proceseve natyrore te klimes. Tek punonjesit qe mund te jene te ekspozuar ne keto shkarkime rekomandohet perdorimi i maskave kundra gazeve te demshem.

Nje ndikim i rendesishem ne mjedisin atmosferik do te vleresohen rastet e renies se zjarrit ne objekt dhe djegia e karburantit. Kjo mundesi eshte e rralle por jo e perjashtuar. Nje ngjarje e tille do te shkaktoje ndotje serioze ne ajer, emetimin e sasive te medha te gazeve te demshem ne nje zone te caktuar dhe nje shtrirje siperfaqesore relativisht te madhe. Gjithashtu mjetet rrugore qe qarkullojne duhet te jene konform normave te percaktuara dhe te testuara nga Qendra e Kontrollit Teknik te automjeteve e te pajisura me certifikaten e Vertetimit Teknik nga IQT.

Depozitat e naftës nuk do të jenë burim emetimi tegazeve ndotese , për arsye se nuk ka proces djegie që mund të emetohen gaze në atmosferë. Gjithashtu, parashikohet që nuk do të shkaktohet pluhur gjatë funksionimit sepse të gjitha hapsirat dhe sheshet ku do të kalojnë dhe do të parkohen autobotet do të jenë të shtruara mebeton dhe në disa pjesë me asfalt.

Zhurmat kryesisht do te krijohen nga levizja e automjeteve. Burimet e zhurmave jane ne siperfaqe. Çdo burim perhap vale zhurme. Fusha akustike qe rezulton varet nga karakteristikat e absorbimit dhe reflektimeve te te gjitha pengesave ekzistuese, ndermjet burimit dhe receptorit.

Energjia zvoglohet per gjate rruges si rezultat i absorbimit te siperfaqeve, divergjences gjeometrike dhe absorbimit atmosferik.

Program i perdorur per llogaritjen e nivelit te zhurmave merr parasysh faktori

“A” – niveli i presionit te zhurmes te llogaritur

Faktori « A » perbehet nga kontribuesit qe vijojne

Niveli i fuqise se zhurmës në drejtim të përhapjes $L_{ne\ drejtim\ te\ eres}$, llogaritet për çdo burim

$$L_{ne\ drejtim\ te\ eres} = L_{W_} - A$$

Niveli i zhurmësve të këtyre automjeteve, është i atij niveli që nuk influencën si për të punësuarit dhe për banorët dhe gjallesat për rreth të tij. Fenomene të tilla si vibracion zhvillimi i aktivitetit nuk do të ketë.

Mbetjet që krijohen do të jenë vetëm mbetje me karakter urban nga aktiviteti i perditshëm i punonjësve. Këto mbetje do të grumbullohen në kosha plastike dhe me pas do të depozitohen në vendin e caktuar nga bashkia.

Informacion për kohezgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar

Gjatë fazës normale të zhvillimit të projektit nuk do të ketë emetime të gazeve, lëngjeve, mbetjeve toksike, helme të ndryshme dhe substanca të tjera të dëmshme, të cilat mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e punonjësve, banorëve dhe mjedisin përreth, floren dhe faunën e zonës, burimet ujore.

Aktiviteti që do të zhvillohet konsiston në magazinimin e lëndës djegëse fosile në depozita dhe furnizimin e mjeteve. Kohezgjatja e zhvillimit të aktivitetit nuk është përcaktuar nga investitori, sepse kjo varet edhe nga kërkesa e tregut dhe shitja e lëndës djegëse.

Te dhëna për shtrirjen e mundshme hapësimore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendodhja e projektit dhe velrat e ndikuara që përfshihen në të

Duke njohur aktivitetin që do të zhvillohet u identifikuan ndikimet e mundshme negative në çdo receptorë - përberës të mjedisit.

Identifikimi i ndikimeve – Përmes të cilit u përcaktua ndryeshmëri mjedis-projekt, u identifikuan ndikimet e mundshme gjatë kesaj faze sipas receptorëve të mjedisit.

Vlerësimi i ndikimeve – Ekspertët mjedisorë të fushave të ndryshme bënë përpjekje për matjen e gravitetit të ndikimeve. Vlerësimi i Sinjifikancës ka të bëjë me vete rëndësinë e ndikimeve dhe është faza më e rëndësishme për zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe përfaqëson atë me objektivisht me teresinë e bashkëveprimeve midis projektit dhe mjedisit. Kriteret e përdorur për vlerësimin e rëndësise së ndikimeve variojnë dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit të ndikuar.

Shtrirja fizike- Vlerëson sipërfaqen apo dimensionin hapësior të një ndikimi të dhënë në raport me burimin që gjeneron atë ndikim.

- **Kohezgjatja e ndikimit** – Vlerëson se sa do të zgjase një ndikim i caktuar në dimensionin kohë (ndikim i përhershëm apo i përkohshëm).

-**Kthyeshmëria** –Vlerëson mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar në gjendjen e tij të mëparshme (aftësia për tu rehabilituar dhe regjeneruar)

-Rendesia – Realizon nje vleresim total te tre permasave te mesiperme dhe njekohesisht thekson vemendjen qe duhet patur per administrimin e ndikimit.

Ndikimet e parashikuara nuk kane shtrirje te madhe fizike, magazinimi i lendes djegese fosile ne depozite nuk ka ndikime negative ne zone. Zhurmat qe krijohen nga levizja e boteve furnizuese dhemjeteve qe do te frunizohen nuk perbejn ndotje akustike. Analiza e frekuences te zhurmes te emetuar nga keto mjete tregon se ato ndodhen nen mesataren e frekuences 100 – 150 Hz , e cila eshte e pranueshme nga veshi i njeriut . Koha ne te cilen do te jene te pranishme keto zhurma eshte vetem gjate furnizimit. Niveli i zhurmave te ketyre mjeteve ne largesi nuk do te jete i madh dhe do te jete konform normave ne fuqi.

Ndikimi negativ mund te perhapet deri ne disa qindra metra, ketu behet fjale per avujt e hidrokarbureve . Ne rastet e emergjencave dhe te avarive te cilat mund te shoqerohen me katastrofa ekologjike ato mund ti shtrijne efektet e tyre deri ne disa kilometra katrore. Perhapja e avujve eshte e perkoshme vetem gjate fazes se ngarkim shkarkimit dhe nuk ka veti akumuluese ne mjedis. Nuk shkarkohen elemente te demshme per mjedisin si ne ate uhor per ajrin, token dhe biodiversitetin. Per parandalimin e ketyre efekteve subjekti duhet te zbatoje me perpikemri projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe zbatimin e kushteve teknike. Duhet te kontrolloje dhe kolaudoje ne menyre korrekte dhe te rregullt nga IQT cdo vit enet nen presion, perfshi edhe valvulat e sigurise edhe saraqineskat , elektropompat, instalimet elektrike te jene korrekte dhe te reja etj.

Ne kushte normale te zhvillimit te aktivitetit nuk vleresohen ndikime te rendesishme te cilat mund te shkaktojne ndotje ne distance te medha.

Mundesine e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme si dhe kostot financiare te peraferta per rehabilitimin

Aktiviteti zhvillohet ne kushte teper te mira , higjienike dhe te kendshme estetikisht. Eshte kryer nje menaxhim I mire I te gjithë hapësirës së siperfaqes duke u gjelberuar ,duke ushtruar me beton me lluster per izolimin e filtrimeve te mundshme.

Duke qen terren kodrinor jane ndertuar te gjitha sistemet e kanalizimeve dhe te drenazhimit te zones. Nuk eshte prekur nga permbytjet ,nuk eshte vleresuar si zone me rrezikshmeri per shkaqe natyrore. Ne rast te mbylljes se aktivitetit , rehabilitimi do te perfshij cmontimin e depozitave prishjen e jastekeve te betonit ku jane mbeshtetur si dhe te shesheve te betonit, nivelim te siperfaqes, mbjellje te fidaneve qe rriten ne zone ne perimetrin rrethues. Siperfaqja e prones eshte e pershtatshme edhe per zhvillime te aktiviteteve te tjera qe mund te zhvilloj subjekti qe e ka pronesi.

Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis

Me qellim qe te parandalohen , shmangen minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore te aktivitetit gjate zhvillimit te tij, investitori duhet te marr masat e duhura per mbrojtjen e mjedisit.

Masat zbutëse për reduktimin e ndikimeve në ajër

Gjatë fazës së operimit burimet nga të cilat shkaktohen dhe emetohen gaze dhe grimca të ngurta janë: lëvizja e automjeteve dhe proceset teknike të operimit. Për këto aktivitete kompania të zbatojë masat zbutëse e mëposhtme:

1. Lënda djegëse e cila do të përdoret nga mjetet dhe automjetet që do të operojnë gjatë fazës furnizimit dhe transportit të naftës të jetë e një cilësie të mirë.
2. Mjetet dhe automjetet që do të përdoren gjatë fazës së operimit do të jenë kryer serviset teknike e duhura.
3. Mjetet dhe automjete që do të përdoren nuk do të jenë të amortizuara të cilat mund të shkaktojnë emetime të gazeve në nivele të larta në atmosferë.
4. Të realizohet spërkatja e ambjenteve në mënyrë që të reduktohet sasia e pluhurit që mund të shkaktohet gjatë livizjes së automjeteve.
5. Ambjentet përreth pikes së karburantit të spërkatën me ujë për të shmangur pluhurin.

Masat zbutëse për reduktimin e ndikimeve në tokë

Në bazë të analizës së vlerësimit ndikimet në cilësinë e tokës do të hasen vetëm në rast se do të ketë shkarkime aksidentale të hidrokarbureve të cilat ndikojnë në ndotjen e asaj sipërfaqeje. Madhësia e këtij ndikimi do të jetë në varësi të madhësisë së aksidentit. Kompania duhet të aplikojë masa për parandalimin e cdo aksidenti në mjedis.

- Kompania të përcaktojë një vend të caktuar dhe të pajisuar me kosha për grumbullimin e mbetjeve urbane.
- Cdo lëndë ndihmëse do të magazinohet në kushte optimale në mënyrë që të mos ndodh asnjë lloj shakrkimi aksidental në tokë.

-Gjatë perimetrisë së sipërfaqes ku do të operojë kompania të hapen kanale kulluese në mënyrë që të sistemohen ujërat sipërfaqësorë të sheshit dhe të kontrollohet cdo lloj derdhje brenda sipërfaqes së projektit.

Kompania operon më ndërgjegjësimit të lartë mjedisor. Kjo duket edhe nga ambjentet brenda territorit ku ajo operon janë të shtruara me beton, të pastra dhe asnjë lloj mbetje nuk është e përhapur në tokë. Ky lloj menaxhimi shmang edhe ndotjen e tokës.

Masat zbutëse për reduktimin e ndikimeve në ujrat sipërfaqësorë

Operimi i këtij lloj projekti nuk gjeneron ujra teknologjik dhe për këtë arsye nuk ndikon në mënyrë të drejtë për drejtë në ujrat sipërfaqësorë.

-Të sistemojë ujrat sipërfaqësorë të sheshit në të cilin do të operojë.

Masat zbutëse për reduktimin e ndikimeve në biodiversitet

- Subjekti në fazën e operimit të kryejë monitorim periodik të nivelit të zhurmave që gjenerohen, në mënyrë që ato të mos jenë shqetësuese për mjedisin natyror.
- Rrugët dytësore dhe e gjithë infrastruktura që do të përdoret subjekti për zbatimin e këtij projekti të spërkatën në mënyrë periodike për të ulur nivelin e përhapjes së grimcave të ngurta në atmosferë.
- Ndricimi i zonës ku do të zhvillohet projektit gjatë natës të projektohet në atë mënyrë që të mos jetë shqetësues për kafshët e egra.

Masat zbutëse për reduktimin e ndikimeve në peisazh

Për zbutjen e ndikimeve nga prania e projektit në peisazhin natyror kompania të zbatojë këto

masa gjatë fazës operimit:

- Përreth sheshit të mbillen pemë të larta
- Mjedis të mbahet i sistemuar dhe i pastër
- Të shmangen shkatimi dhe përhapja e pluhurit në atmosfere
- Të shmangët grumbullimi i mbetjeve për një kohë të gjatë

Masat ekzistuese për parandalimin e aksidenteve ose sistemet e reagimit në rast emergjencash.

Sherbimi i Sigurisë së Kompanisë operon në kushtet e nivelit të sigurisë Nr.1 dhe ka si mision të saj Garantimin e Sigurisë së Jetes dhe të aktivitetit ekonomik të kompanisë.

1. Ajo e realizon atë:

- a. Nepermjet zbulimit dhe vlerësimit ndaj kercenimeve të sigurisë dhe marrjen e masave paraprake kundrejt incidenteve që prekin sigurinë e kompanisë;
- b. Nepermjet përcaktimit të detyrave konkrete dhe përgjithësive funksionale të Sherbimit të Sigurisë për të vendosur sigurinë;
- c. Nepermjet sigurimit të një kembimi të shpejtë dhe objektiv të informacioneve me Policinë e Shtetit ;
- d. Nepermjet pasjes së një metodologjie të vlerësimit të gjendjes së sigurisë, për të vepruar siç duhet në rastet e ndryshimit të nivelit të sigurisë.

Sherbimi i Sigurisë është përgjegjës për ruajtjen, mbrojtjen, sigurinë dhe zhvillimin në kushte normale të operacioneve të ngarkimit të automjeteve me lende djegëse

Për të parandaluar dhe përballuar situata emergjence me personelin e sherbimit dhe atë punonjes të kompanisë ,jane programuar dhe zhvilluar tema stervitje, alarme e ushtrime në drejtim të ndergjegjesimit për zjarrin; të dallimit të objekteve dhe personave të dyshimte; të kercenimit me bombe apo pakot e dyshimta me synimin, që,çdo punonjes i kompanisë si me dhe, pa detyra të veçanta sigurie të ndergjegjesohen me detyrat e sigurisë.

Masat specifike për parandalimin e zjarrit

Masat kryesore të mbrojtjes nga zjarri finalizohen me zvogëlim të probabilitetit të ndodhjes së një zjarri , ato individualizohen si më poshtë:

Realizimi I impianteve elektrike sipas të gjitha rregullave

Zjarret shkaktohen në rreth 30% të rasteve nga përdorimi i defektos I lidhjeve elektrike, prandaj del e domosdoshme rëndësia e marrjes së masave për përgatitjen dhe montimin e impianteve elektrike sipas të gjitha rregullave pasi kështu bëhet e mundur që të ulen në mënyrë të ndjeshme shkaqet kryesore të zjarreve.

Lidhjen me tokezim tokësor të gjitha pajisjeve , impianteve, strukturave të depozitave

Tokezimi I impianteve elektrike, të depozitave dhe strukturave të tjera krijon mundësinë që në këto elemente të realizohet shkarkimi I ngarkesave elektro statike që mund të bëhen shkak për lindje zjarresh.

Edhe shkarkesat atmosferike përbejnë një faktor kryesor për ndezjen e zjarreve, për këtë në mënyrë të veçantë në zonat ku këto janë me intensive bëhet e domosdoshme ndërtimi I mbrojtjes atmosferike. Aplikimi i tyre bëhet që shkarkimi atmosferik elektrik të bëhet nepermjet rrufepritesave në toke dhe jo në ndërtesa apo depozite.

Instalimin e impianteve te mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike
Depozitat e ruajtjes se naftes pajisen me mjete sigurie te llojeve te ndryshme si termostate, celesa fundore te niveleve max dhe min, pajisje alarmi per sinjalizim te ngopshmerise se avujve dhe gazeve ne mjediset e punes
Ventilim natyral dhe artificial te ambjenteve te mbyllura
Kompletimin me pajisjet anti zjarr
Sinjalistiken siguruese sidomos referuar rreziqeve qe ekzistojne ne vendet e punes

Nga ana e shoqerise do te caktohet nje person per mbrojtjen nga zjarri I cili ben verifikimin e zbatimit te rregullave ne vendet e punes per ndjekjen e zbatimit te tyre. Punonjesit keshillohen qe para se te largohen nga vendi I punes apo ne perfundim te orarit te punes duhet te bej pastrimin dhe lenien e tij ne kondita te sigurta per mbrojtje nga zjarri. Kryhet kontroll periodik per mjetet e mbrojtjes ndaj zjarrit, sistemeve te alarmit dhe pajisjeve elektrike.

Kontroll operativ I gjendjes se fikesave dhe depozites se ujit

Cdo fikesa zjarri ne vendin e caktuar inspektohet cdo muaj . Gjate inspektimi vizual verifikohet :

- Fikesi te jet I vendosur afer vendit potencialisht te rrezikshem
- Nuk duhet te jete I boshatisur
- Siguresa nuk duhet te jete e prekur ose e ndotur
- Shigjeta e presionit duhet te jete ne fushen e duhur
- Nuk duhet te kete demtime mekanike ose korrozioni ose zenie te duzes se gypit hedhes
- Vendi perreth fikeses te jete I paster dhe pa pengesa
- Vendodhja te jete e dukshme
- Cdo konstatimi pa rregullt raportohet per marrjen e masave

Programi i monitorimit të mjedisit

Qëllimi i monitorimit mjedisor është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performance mjedisore të zbatimit të projektit.

Monitorimi i mjedisit është detyrim ligjor, mënyra, frekuenca dhe elementët e monitorimit janë të ndryshëm për veprimtari të ndryshme. Në vijim do të paraqesim elementët që duhet të monitorojë subjekti gjatë funksionimit të implantit. Elementët e tjerë apo përcaktimi I frekuencave të monitorimit do të përcaktohet në akt miratimin e lejes mjedisore për këtë veprimtari.